



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:251671
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05438856

C-IV.-14-5606

Ankuesi:

O B nga Prishtina.
*Përfaqësuar nga avokat **B I** nga Prishtina.*

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “Ingeniering”, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht ankesa dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN129-0021 dt.15 maj 2014.

OBLIGOHET e paditura AKP, që ankuesit O B në emër të Kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës t’i paguaj **shumën prej 2,252.00€** dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore t’i paguaj shumën prej **225.00€**. Ndërsa, shuma e kërkesës përtej shumës së aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

OBLIGOHET e paditura që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **134.00€**.

II.HUDHET ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN129-0022 dt.27 maj 2014.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.19 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një kërkesë kundër Vendimit nr. PRN129-0026 dt.13 maj 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej **47,600.00€**, nga N.SH “Ingeniering” (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se vendimi i AKP-së nuk ka bazë të vlefshme juridike pasi që Ligji për Punën e Bashkuar është shfuqizuar që d.m.th se kërkesa për paga nuk është parashkruar, dhe se ligji është i qartë dhe se i takon e drejta e kompensimit për paga. Ankesës i ka bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Llogaritja e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006, Vërtetim i lëshuar nga NSH-ja, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

I autorizuari i ankuesit me dt.21 prill 2020, në gjykatë ka paraqitur parashtresë për rregullimin dhe plotësimin e padisë, me anë të së cilës e ka atakuar vendimin e AL nr. PRN129-0022 dt.27 maj 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për largim nga puna për shkak të masave të dhunshme për periudhën 2 prill 1992 deri me dt.30 qershor 1999, në shumë prej 36,500.27€ nga NSH “Ingeniering”. Së bashku me këtë ankesë ka bashkëngjitur: Procesverbal dt.09.12.1991, Vendim nr.429/92 dt.20.04.1992, Padi drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë viti 1992, Vendimi i përkohshëm për caktimin me një vend të ri pune, dëshmi për ndërprerjen e punës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Vendimi nr.4 dt.01.07.1999, Vërtetim i lëshuar nga NSH-ja, Vendimi nr.10 dt.10.02.2005, Padi drejtuar Gjykatës Komunale Prishtinë dt.13.04.2006, Llogaritja e dëmit në emër të kompensimit të të ardhurave personale të punëtorëve të dëmtuar, Ankese drejtuar Gjykatës së Qarkut Prishtinë dt.19.06.2006, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Vendimi nr.PRN129-0022 dt.27 maj 2014.

Me dt.08 gusht 2023, e paditura parashtroi mbrojtjen e saj në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Pala kërkuese e ka barrën e provës në bazë të dispozitave ligjore dhe se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument mbi të cilin do ti mbështeste pretendimet e tij. Andaj i kundërshtoi të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesën e tij duke i konsideruara si të pa bazuara dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me dt.30 gusht 2023, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin përmes të cilit kërkoj që të bëjë dorëzimin e kopjes së librezës së punës si dhe prova që NSH i ka mbetur borxh për periudhën 1992-1999. I autorizuari i ankuesit i është përgjigjur gjykatës përmes parashtresës së dt.13 shtator 2023, duke bërë dorëzimin provave të cilat i kishte dorëzuar dhe më parë përmes ankesës si dhe të Kontratën e punës dt.16.01.2002.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 71 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi parashtroi kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit/Agjencia Kosovare e Privatizimit me dt.02 tetor 2013, ndërsa Autoriteti i Likuidimit e refuzoi kërkesën me dt.15 maj 2014.

Gjykata konstaton se faktet e mëposhtme janë jokontestuese: Ankesa u regjistrua në Dhomën e Posaçme me dt.19 qershor 2014, Ankuesi kishte punuar në NSH nga dt.11 qershor 1980 deri me dt.14 janar 2009.

Gjykata i konstaton si kontestuese çështjet e mëposhtme: Pranueshmëria e ankesës varet nga përgjigja në çështjen e parashtrimit të ankesës brenda afatit të paraparë me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 04/L-034) dhe nenit 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Pranueshmëria

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme me dt.19 qershor 2014, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0021 dt.15 maj 2014.

Po ashtu, gjykata gjen se është fakt i pa kontestuar se ankuesi ka punuar për NSH-në deri në marrje e njoftimit me dt. 14 janar 2009, që nënkupton se Gjykata merr parasysh kur e llogarit periudhën e punësimit e cila e përcakton shumën e parave që duhet të paguhet si dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës, faktin se ankuesit - punëtorit marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë deri me marrjen e njoftimit të dt. 14 janar 2009.

Ligji në fuqi

Ligji për Ndërmarrjet (77/88) hyri në fuqi më 01.01.1989 dhe është ligj në fuqi në Kosovë. Ligji për Ndërmarrjet i shfuqizon vetëm ato dispozita të Ligjit për Punën e Bashkuar që janë në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Ligji për Ndërmarrjet, sidoqoftë, nuk u jep ndonjë përgjigje çështjeve që trajtohen me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Për këtë arsye, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar në asnjë mënyrë nuk është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 parasheh se ligjet që janë miratuar nga Kuvendi i Jugosllavisë/Serbisë pas dt.22.03.1989 nuk janë ligje në fuqi në Kosovë.

Pasi që kërkesa është dorëzuar në AL brenda afatit, njoftimi për ndërprerje është i dt.14 janar 2009, rezulton se e drejta e ankuesit për dëmshpërblim është e afatshme, sikurse edhe me të njëjtën dëshmohet se ankuesit asnjëherë më parë nuk i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim gjykata duke u bazuar në deklaratat e pakontestueshme të dyja palëve, edhe pse AL në mbrojtjen e paraqitur nuk e kontestoj asnjëherë si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e shumës të cilën e kërkoj ankuesi, gjykata gjeti se kërkesa e ankuesit është ligjore dhe asnjëherë nuk i ishte parashkruar, pasi që parashkrimi ishte ndërprerë me Njoftimin e dt. 14 janar 2009.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Futja e NSH në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë.

Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dt. 14 janar 2009, dëshmon se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në deri me marrjen e këtij njoftimi, po ashtu kjo dëshmohet edhe vërtetimin e lëshuar nga NSH-ja, pra e ai kishte ofruar shërbime për NSH-në deri në kohën e likuidimit të saj.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në Listën e të ardhurave personale për muajin Dhjetor 2006, ku ankuesi pagën e fundit e cila i ishte paguar ishte në shumë prej 563.00€, kurse nga Vërtetimi i lëshuar nga NSH-ja, vërtetohet se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në nga dt.11 qershor 1981 deri me dt.14 janar 2009, e që i bie se ka ofruar shërbime për 28 vite. Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore erdhi në përfundim se ankuesit i takojnë 4 paga e që i bie (4 x 563.00€=2,252.00€).

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 225.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo

shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Pjesa e hudhjes

Hudhet si e pas afatshme ankesa kundër vendimi i kundërshtuar i AL nr.PRN129-0022 dt.27 maj 2014.

Neni 37.7. i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, parasheh: “Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkonte i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit.”

Dhoma e Posaçme pasi ka shqyrtuar me kujdes ankesën dhe dokumentacionin përcjellës ka gjetur se ankesa nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 28.2.2.6 dhe 70.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe/ose nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Ankuesi nuk e ka dorëzuar ankesën në gjykatë brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur ai ka pranuar vendimin e ankimuar. Sipas vendimit të ankimuar data e lëshimit të tij është 15 maj 2014. Ankuesi dorëzoi ankesën e tij kundër vendimit në fjalë me 21 prill 2020, që do të thotë gjashtë vite pas afatit.

Për këtë në pajtim me nenet 28.1, 28.2, 28.3 dhe 70.2 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme, Ankesa kundër Vendimit Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN129-0022 dt.27 maj 2014, për dëmshpërblim për largim nga puna për shkak të masave të dhunshme hedhet poshtë si e papranueshme.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesë me dt.21 korrik 2023.

E paditura është obliguar që ti paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00€, në bazë të rregullores së Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe atë shumën prej 104.00€ për ankesë, si dhe 30.00€ për taksë gjyqësore. Shuma prej 104.00€ për përgjigje në mbrojtje u refuzua si e pa bazuar, pasi ankuesi nuk e ka paraqitur të njëjtën.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrije Shala